GSA SHPK

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

DHE PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

PERMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESIT 4
PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE E KONSOLIDUAR 5
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR E KONSOLIDUAR 6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL E KONSOLIDUAR 7
PASQYRA E KONSOLIDUAR E CASH FLOW – METODA INDIREKTE 8
1. INFORMACION MBI SHOQËRINË 9
2. BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË 10
2.1 Deklarata e përputhshmërisë 10
2.2 Baza e matjes 10
2.3 Monedha funksionale dhe raportuese 10
2.4 Parimi i vijimësisë 11
3. PËRMBLEDHJE E POLITIKA MË TË RËNDËSISHME KONTABËL 11
3.1. Gjykimet dhe vlerësimet 11
a. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare 11
b. Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme 11
c. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme 11
d. Tatimi mbi fitimin 12
e. Llogaritja e vlerës së realizueshme neto për inventarët 12
f. Përcaktimi i vlerës së drejtë 12
3.2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL 12
a. Transaksionet në monedha të huaja 12
b. Instrumentet financiarë 12
c. Aktivet Financiare 12
d. Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj 14
e. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera 14
f. Aktive nga kontratat 14
g. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera 15
h. Detyrime nga kontratat 15
i. Provizionet 15
j. Përfitimet e punonjësve 15
k. Inventarët 15
l. Aktive afatgjata materiale 16
m. Zhvlerësim i aktiveve jo financiare 16
n. Kapitali 17
o. Të ardhurat nga kontratat me klientët 17
p. Të ardhurat dhe kostot financiare 18
q. Shpenzime për tatim fitimin 18
r. Qiratë 18
s. Shpërndarja e fitimit 19
t. Të drejtat dhe detyrimet tatimore 19
u. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara 19
4. STANDARDET DHE INTERPRETIMET E PUBLIKUARA POR EFEKTIVE NË PERIUDHAT VIJUESE 19
5. TË ARDHURAT 19
6. SHPENZIMET DIREKTE 20
7. TË ARDHURAT NGA INVESTIMET 20
8. SHPENZIMET E PERSONELIT 20
9. TE ARDHURA TE TJERA 21
9.1. TE ARDHURA TE TJERA 21
9.2. Fitim/humbje nga këmbimet valutore 21
10. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE 21
11. TATIMIT MBI TË ARDHURAT DHE TATIMI I SHTYRE 21
12. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE 23
13. AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE 24
14. INVENTARET 24
15. INVESTIMET NE FILIALE 25
16. AKTIVE TE KONTRATES / KOSTO TE REALIZIMIT TE KONTRATES 26
17. TE DREJTAT TREGETARE TE ARKETUESHME / DETYRIM KONTRATE 26
18. TE TJERA TE ARKETUESHME 27
19. MJETE MONETARE NE ARKE DHE NE BANKE 27

20. KAPITALI 27
21. HUADHENIE DHE HUAMARRJE, BORXHE NGA INSTITUCIONET FINANCIARE 28
22. DETYRIME TREGETARE TE PAGUESHME 29
23. DETYRIME TE TJERA TE PAGUESHME 30
24. GARANCI 30
25. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR 31
a) Rreziku i normave te interesit 31
b) Rreziku i kursit te kembimit 32
c) Rreziku i Likuiditetit 33
d) Rreziku i Kreditit 33
26. VLERA E DREJTE 34
27. MENAXHIMI I KAPITALIT 34
28. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA 35
29. PALËT E LIDHURA 35
30. NGJARJET PAS PERIUDHËS RAPORTUESE 36
31. MIRATIMI I PASQYRAVE FINANCIARE TË KONSOLIDUARA 36

RAPORT I AUDITUESVE TË PAVARUR

Drejtuar: Ortakëve dhe Drejtuesve të shoqërisë "GSA" sh.p.k.
Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr.64,
Tiranë, Shqipëri

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë "GSA" sh.p.k. (më poshtë "Shoqëria") me NUIS J61820031J, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të konsoliduar me datë 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse të konsoliduar, pasqyrën e ndryshimeve në kapital të konsoliduar dhe pasqyrën e flukseve të parasë të konsoliduar për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të hartuar nga Bordi i Standardeve Ndëkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël dhe kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërise, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë proçedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë proçedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, me qëllim të paraqitjes së drejtë të transaksioneve dhe ngjarjeve të periudhës kontabël, për efekt të këtij raporti.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Vjollca DERVISHI
Auditues Ligjor
Rr. Frederik Shiroka, Pall.1, Shk.3, Ap.5
Tiranë, Shqipëri

Vera LALA
Auditues Ligjor
Venis-Audit & Financë shp.k.
Rr. "Fadil Rada", P. Rruga-Ura, Ap.1, Sh.2,
Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 03.05.2021

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE E KONSOLIDUAR
Per vitin financiar qe mbyllet ne 31 Dhjetor 2020

		Viti 2020 ne 000 Lek	Viti 2019 ne 000 Lek
Shitje e mallrave dhe produkteve	5	8,105,472	10,035,434
Te tjera te ardhura	9.1	1,069	183,948
Total te ardhura		**8,106,541**	**10,219,382**
Ndryshime ne inventar	14.1	535,543	533,974
Blerje materialeve/mallra	6	(7,702,614)	(9,509,452)
Shpenzime personeli	8	(195,703)	(189,487)
Shpenzime te përgjithshme & admin	10	(104,638)	(128,869)
Shpenzime amortizimi	12-13	(134,047)	(152,910)
Te ardhura / shpenzime te zhvlerësimit	14	-	(148,657)
Fitim/humbje nga këmbimet valutorë	9.2	80,160	(8,870)
		-	-
Total kosto operative		**(7,521,299)**	**(9,604,272)**
Fitim/(humbje) nga aktiviteti operativ		**585,243**	**615,110**
Te ardhura nga interesat	7	2,495	4,149
Shpenzime nga interesat	21.5	(131,074)	(125,645)
Fitim/(humbje) para tatimit		**456,663**	**493,614**
Shpenzime tatim fitimi	11.1	(46,137)	(99,190)
E ardhur/(Shpenzim) i tatimit të shtyrë	11.2	13,387	(4,855)
Fitim/(humbje) neto	20.2	**423,914**	**389,569**

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe aprovuar per publikim ne date 30 Prill, 2021 nga:

Serafin Orgocka
Administrator

Eglis Flaga
Drejtor Finance

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse do te lexohet se bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri 36, te cilat janë pjese integrale e Pasqyrave Financiare te Konsoliduara

IBRAHIM RUGOVA 64, TIRANA-ALBANIA
GSA
SHPK
J61820031J

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR E KONSOLIDUAR
Per vitin financiar qe mbyllet ne 31 dhjetor 2020

	Shënime	31/12/2020 ne 000 Lek	31/12/2019 ne 000 Lek
Aktive materiale	12	2,135,881	2,096,554
Aktive jo-materiale	13	2,676	3,445
Investime ne filiale	15	0	0
Garanci	24/1	146,604	143,788
Aktivi tatimor i shtyre	11/2	13,838	451
Huadhënie me interes	21/1	-	41,402
Totali i aktiveve afatgjata		**2,298,999**	**2,285,639**
Cash dhe ekuivalentet e cash-it	19	932,620	1,048,129
Inventari	14	1,866,486	1,526,753
Te drejtat tregtarë te arkëtueshme	17/1	2,625,731	2,381,697
Aktive te kontratës	16/1	135,937	159,038
Kosto te realizimit te kontratave	16/2	67,393	27,255
E drejte për tatim fitimi	11/1	66,154	70,449
Instrumente financiare	21/2	47,977	2,378
Garanci	24/2	120,356	194,629
Kërkesa te tjera te arkëtueshme	18	533,637	676,739
Totali i aktiveve afatshkurtra		**6,396,292**	**6,087,067**
TOTALI I AKTIVIT		**8,695,292**	**8,372,706**
Kapitali aksionar	20/1	28,100	28,100
Fitim humbjet e mbartura	20/2	4,904,164	4,480,069
Totali I kapitalit aksionar	20	**4,932,264**	**4,508,169**
Hua, Kredi nga institucionet financiare etj.	21/3	876,566	923,400
Klient parapagime	17/2	11,940	21,753
Pasivi tatimor i shtyre		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		**888,506**	**945,153**
Interesa, Kredi dhe Overdrafte	21/4	2,465,071	2,492,578
Te drejtat tregtarë te pagueshme	22	369,251	288,109
Kredi nga aksioneri		-	-
Dividend	20/3	24,236	123,175
Detyrime te tjera te pagueshme	23	15,964	15,523
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**2,874,522**	**2,919,385**
Totali i detyrimeve		**3,763,028**	**3,864,537**
TOTAL DETYRIME & KAPITAL		**8,695,292**	**8,372,706**

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe aprovuar per publikim ne date 30 Prill, 2021 nga:

Serafin Orgocka
Administrator

Eglis Flaga
Drejtor Finance

IBRAHIM RUGOVA 64, TIRANA-ALBANIA GSA SHPK J61820031J

Pasqyra e Pozicionit Financar do te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri 36, te ollat jane pjese integrale e Pasqyrave Financiare

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL E KONSOLIDUAR
Per vitin financiar qe mbyllet ne 31 Dhjetor 2020

	Shënime	Kapitali fillestar	Fitim/(humbje) mbartur	Total
		in 000 Lek	in 000 Lek	in 000 Lek
Balanca ne 31 Dhjetor 2018	**20**	**28,100**	**4,981,136**	**5,009,236**
Fitim/(humbje) e periudhës		-	389,569	389,569
Shpërndarje fitimi		-	(890,534)	(890,534)
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	(103)	(103)
Balanca ne 31 Dhjetor 2019	**20**	**28,100**	**4,480,069**	**4,508,169**
Fitim / (humbje) e periudhës		-	423,914	423,914
Shpërndarje fitimi		-	-	-
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse		-	181	181
Balanca ne 31 Dhjetor 2020	**20**	**28,100**	**4,904,164**	**4,932,264**

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe aprovuar per publikim ne date 30 Prill, 2021 nga:

Serafin Orgocka
Administrator

Eglis Flaga
Drejtor Finance

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital do te lexohet se bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 9 deri 36, te cilat janë pjese integrale e Pasqyrave Financiare te Konsoliduara

PASQYRA E KONSOLIDUAR E CASH FLOW – METODA INDIREKTE
Per vitin financiar qe mbyllet ne 31 Dhjetor 2020

	Shënime	Viti 2020 në '000 Lek	Viti 2019 në '000 Lek
Aktivitetet e shfrytëzimit			
Fitimi pas tatimit		**423,914**	**389,467**
Rregullime për të rakorduar humbjen neto me fluksin neto të parasë		-	-
Amortizime dhe zhvlerësime	**12-13**	134,047	152,910
Rivlerësime te inventarit	**14**	(158,470)	(168,351)
Te ardhura nga interesat		(0)	(4,149)
Shpenzime për interesa	**21&5**	85,862	125,553
Fitim/(humbje) nga kursi këmbimit	**9**	12,291	(79,973)
Arkëtime jo cash nga parapagime taksave		-	-
Rimarrje/Zhvlerësime I llogarive te arkëtueshme		-	(1,033)
Provigjone		-	-
Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve		-	-
Tatim i shtyre	**11**	(13,387)	4,855
		484,255	**419,278**
Rregullime ne kapitalin punues			
Ndryshim në inventar	**14**	(181,263)	(131,657)
Ndryshim në llogari të arkëtueshme dhe te tjera		(77,879)	65,342
Ndryshim në llogari të arkëtueshme afatgjata		(14,442)	(34,708)
Ndryshim në llogari të pagueshme dhe te tjera	**20,22, 23**	81,583	(656,643)
Ndryshimet ne kapitalin punues		**(192,001)**	**(757,665)**
Cash flow nga aktiviteti operativ		**292,254**	**(338,388)**
Interes i paguar		(85,862)	(103,372)
Tatim fitimi		(41,842)	(133,898)
Mjetet monetare neto të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		**164,551**	**(575,657)**
Cash flow nga aktiviteti investues			
Blerje aktive afatgjata materiale	**12**	(172,091)	(584,966)
Blerje aktive afatgjata jo-materiale	**13**	(514)	(540)
Investime ne filiale	**15**	(1,058)	0
Hua te dhëna	**21/2**	(4,197)	(43,780)
Kthimi huase		-	6,542
Mjetet monetare neto nga aktivitetet investuese		**(177,861)**	**(622,744)**
Cash flow nga aktiviteti financues			
Garanci	**24**	71,456	(26,324)
Kredi/overdrafte te marra	**21/4**	-	2,600,219
Kthimi huase/overdraftit	**21/4**	-	(783,266)
Interes i arkëtueshme		-	4,149
Rritje/Pakesim ne kreditë afatgjata	**21/3**	(46,834)	30,306
Disidentë	**20/3**	(99,314)	(163,355)
Rritje/Pakësim ne Overdraftet bankare	**21/4**	(27,507)	(36,421)
Mjetet monetare neto nga aktivitetet investuese		**(102,199)**	**1,625,309**
Rritje/(Pakësim) neto e mjeteve monetare		**(115,509)**	**426,908**
Mjetet monetare në fillim të periudhës	**19**	1,048,129	621,221
Mjetet monetare në fund të periudhës	**19**	**932,620**	**1,048,129**

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe aprovuar per publikim ne date 30 Prill, 2021 nga:

Serafin Orgocka
Administrator

IBRAHIM RUGOVA 64, TIRANA-ALBANIA
GSA
SH P K

Eglis Flaga
Drejtor Finance

Pasqyra e Cash Flow do te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese nga faqja 9 deri 36, te cilat jane pjese integrale e Pasqyrave Financiare te Konsoliduara

1. INFORMACION MBI SHOQËRINË

Shoqëria "GSA" SHPK është regjistruar ne regjistrin tregtar te shoqërive, me vendim gjykate nr. 674/1, date 30.06.1993, te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor ne Tirane.
Veprimtaria e saj rregullohet nga dispozitat përkatëse te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", nga Statuti i Shoqërisë si dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi për tatimet dhe taksat.

Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	J61820031J
Data e Regjistrimit	30/06/1993
Forma ligjore	Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (SHPK)
Data e themelimit	15/06/1993
Kohëzgjatja	Nga: 15/06/1993
Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr.64, Tirane
Kapitali	28,100,000 leke (i paguar ne masën 100%)
Numri i përgjithshëm i kuotave	2 (dy)
Objekti i aktivitetit	Import-eksport, tregtim dhe furnizimi energjisë elektrike si dhe pajisjeve elektrike. Prodhim dhe tregtim, import – eksport i Ferro-Kromit dhe Ferro-Aliazheve. Import - export dhe tregtim i mallrave te tjera
Administratori/ët	Serafin Orgocka
Afati i emërimit	Nga: 02/05/2011 Deri: 11/11/2024
Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	Administratoret kane te drejte ti kryejnë kompetencat veç e veç ne mënyre te pavarur nga njeri tjetri
Administratori/ët	Agron Shapllo
Afati i emërimit	Nga: 02/05/2011 Deri: 11/11/2024
Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	Administratoret kane te drejte ti kryejnë kompetencat veç e veç ne mënyre te pavarur nga njeri tjetri
Ortakët	Serafin Orgocka
Vlera e kapitalit	Para: 11.240.000,00 Natyre: 0
Numri i pjesëve	1
Pjesëmarrja në përqindje	40%
Ortakët	Agron Shapllo
Vlera e kapitalit	Para: 16.860.000,00 Natyre: 0
Numri i pjesëve	1
Pjesëmarrja në përqindje	60%
Adresa sekondare	Rruga "Gjon Kastrioti", nr. 66, Laprake, Tirane (ambient me qira); Zona industriale, Bradashesh, Elbasan (prone e shoqërisë). Container Terminal (DCT), Durrës Port, Durrës (ambient me qira) Container Terminal (DCT), Durrës Port, Xhafzotaj Autostrada Durrës-Tirane, Km. 4 (ambient me qira) Uzina e Prodhimit FeCr ne territorin e Refraktare sha, Elbasan (ambient me qira) Balldren, ne territorin e Refraktare sha, Zona kadestrale 1045, Elbasan (ambient me qira)

Filiale te shoqërisë	**Shoqëria "GSA Energy" doo** Kapitali i shoqërisë: 1,175,886 RSD Ortaku: **GSA** Përqindja ne kapital: 100% Forma juridike: Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (SHPK) Data e regjistrimit: 28 Maj 2012 Aktiviteti: Tregtim i energjisë elektrike Adresa e shoqërisë: Rruga, Toplicin Venac, Beograd-Stari Grad, Serbi Drejtor: Agron Shapllo, Serafin Orgocka **Shoqëria "GSA Energji" ShPK** Kapitali i shoqërisë: 15,000 Euro Ortaku: **GSA** Përqindja ne kapital: 100% Forma juridike: Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (SHPK) Data e regjistrimit: 24 Nëntor 2015 Aktiviteti: Tregtim i energjisë elektrike Adresa e shoqërisë: Rruga, Xheladin Hana, Nr.35/15, Prishtine, Kosove. Drejtor: Serafin Orgocka
Te tjera	Emri Tregtar: GSA E-Mail: info@gsa.al Telefon: 0692025491 Numri mesatar i punonjësve me date 31 Dhjetor 2020 është 153 punonjës (31 Dhjetor 2019, 151 punonjës) Mjetet e transportit janë prone e shoqërisë Filialet e shoqërisë nuk kane realizuar fitim për vitin ushtrimor 2020

2. BAZA E PËRGATITJES DHE DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të përcaktuara nga SNRF-të për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura në vijim. Te dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene ne përputhje me parimet e përgjithshme te kontabilitetit, ne mënyre te veçante me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimësi.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt ('000 Lekë), përveç kur përcaktohet ndryshe

Klasifikimi afatgjatë kundrejt afatshkurtër

Shoqëria prezanton aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar bazuar në klasifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër. Një aktiv është afatshkurtër kur :

- Pritet të realizohet ose ka për qëllim të shitet ose konsumohet brenda ciklit normal të operimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- Pritet te realizohet brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit

- Është në formën e mjeteve monetare ose një ekuivalenti të mjeteve monetare, me përjashtim të rastit kur ai kufizohet për t'u përdorur për këmbim ose për shlyerjen e një detyrimi për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

Të gjithë aktivet e tjera klasifikohen si afatgjata.

Një detyrim klasifikohet si afatshkurtër kur:

- Pritet që të shlyhet brenda ciklit normal të operimit
- Mbahet kryesisht për qëllime tregtimi
- E ka afatin për tu shlyer brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit
- Njësia ekonomike nuk ka ndonjë të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyerjes së detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së bilancit.

Shoqëria klasifikon të gjitha detyrimet e tjera si afatgjatë. Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra klasifikohet si afatgjatë.

2.4 Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim te aftësisë se shoqërisë për te vazhduar aktivitetin ne vijimësi dhe është i kënaqur qe shoqëria ka burime për te vazhduar biznesin ne te ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk eshte ne dijeni te ndonje pasigurie materiale qe mund te sjelle dyshime te konsiderueshme mbi mundesine e shoqerise per te vazhduar ne vijimesi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojne te pergatiten ne baze te parimit te vijimesise.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKA MË TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1. Gjykimet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë, përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohet se janë të përshtatshme për rrethanat aktuale. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë kontabël ose në periudhën gjatë së cilës vlerësimi është rishikuar dhe periudha të ardhshme nëse rishikimi ndikon të dyja periudhat si aktuale dhe të ardhshme.

a. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen me shumën me të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

b. Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr.12-13. Megjithatë rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

c. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria përdor matricën e zhvlerësimit për të llogaritur humbjet e pritshme te kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të drejta të tjera. Humbjet e pritshme të kredisë (HPK) për këto llogari bazohen në normat historike të humbjes dhe në dite vonesat për kategori të ndryshme klientësh të cilët janë grupuar sipas natyrës së transaksionit, llojit të klientit si dhe ndryshimet e ndodhura pas datës raportuese. Matrica bazohet fillimisht në normat historike të mos pagesave të klientëve të Shoqërisë. Shoqëria ka kalibruar matricën për të rregulluar përvojën historike të humbjes së kredisë me informacione për të ardhmen, pasi vlerësimi i lidhjes reciproke mes arkëtimeve dhe këtyre indikatorëve është i pamundur me të dhënat e publikuara. Në çdo datë të raportimit, normat historike të mos pagesave të vëzhguara përditësohen.

Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi, të njohura në këto pasqyra.

d. Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atij të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njeh detyrimin ne rast te kontrollit të mundshëm tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund te lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do ndikojnë në vlerën aktuale te aktiveve dhe pasiveve tatimore aktuale e të shtyra, në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

e. Llogaritja e vlerës së realizueshme neto për inventarët

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto për to, vlerësohet duke iu referuar kushteve të tregut dhe çmimeve që ekzistojnë në datën e raportimit për aktive të ngjashme, minus kostot e përllogaritura për realizimin e shitjes. Meqenëse mallrat që tregton shoqëria kanë cilësi dhe çmim të ndryshëm krahasuar me kategoritë e njëjta të mallrave që tregtohen, treguesi më i mire i vlerësimit është ai specifik, mbështetur në vrojtimin e marzheve individuale të shitjes të periudhës pas datës raportuese, të historisë së humbjeve të ndodhura, si dhe të vrojtimit të tendencës së çmimeve të shitjes për mallra të ngjashme.

f. Përcaktimi i vlerës së drejtë

Shoqëria nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe dhënie informacionesh shpjeguese te miratuara prej saj, të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë për aktivet dhe detyrimet financiare e jo financiare. Vlerat e drejta janë përcaktuar vetëm me qëllim të matjes dhe prezantimit. Drejtimi i shoqërisë vlerëson se vlera e drejtë parave, e llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, e aktiveve te tjera dhe detyrimeve te tjera afatshkurtra dhe e tatimit mbi fitimin, përafrohet me vlerën kontabël për arsye të maturitetit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

3.2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

a. Transaksionet në monedha të huaja

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase “Lek”, e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria. Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës se raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen. Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin. Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë:

Monedha	31.12.2020	31.12.2019
EUR/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

b. Instrumentet financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga të arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, mjete monetare dhe të ngjashme, llogari te pagueshme tregtare dhe të tjera, te arkëtueshme dhe te pagueshme.

c. Aktivet Financiare

Njohja dhe matja fillestare

Aktivet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) dhe vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare në njohjen fillestare varet nga karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar dhe nga modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e tyre. Përveç llogarive të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike te standardit, Shoqëria mat një aktiv financiar me vlerën e drejtë të tij plus kostot e transaksionit, kjo në rastin e një aktivi financiar të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të rëndësishëm financimi ose për të cilat Shoqëria ka zbatuar lehtësimet praktike maten me çmimin e transaksionit të përcaktuar sipas SNRF 15.Në mënyrë që një aktiv financiar të klasifikohet dhe të matet me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, ai duhet të krijojë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI)' për shumën kryesore të papaguar. Ky vlerësim quhet test VPPI dhe kryhet në nivel instrumenti financiar. Modeli i biznesit i Shoqërisë për menaxhimin e aktiveve financiare i referohet mënyrës se si menaxhon aktivet e saj financiare në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare. Shoqëria ka aktive financiare të arkëtueshme tregtare dhe aktive të tjera nga të cilat pret vetëm arkëtimin e principalit dhe interesit në rast se aplikohet.

Matja e mëpasshme

Për qëllime të matjes se mëpasshme, aktivet financiare klasifikohen në katër kategori:

- Aktivet financiare me koston e amortizuar (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes ardhurave gjithëpërfshirëse (“VDATGJ”) me riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative (instrumentet e borxhit);
- Aktivet financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes ardhurave gjithëpërfshirëse (“VDATGJ”) pa riciklimin e fitimeve dhe humbjeve kumulative në momentin e çregjistrimit (instrumentet e kapitalit neto);
- Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (“VDNFH”).

Aktivet financiare me koston e amortizuar

Shoqëria ka aktive financiare vetëm të kategorisë së parë. Shoqëria mat aktivet financiare me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

a) aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi me qëllim të mbajtjes së mjeteve financiare për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe,
b) kushtet kontraktuale të aktivit financiar të japin rritje në data të përcaktuara flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit mbi shumën principale të papaguar.

Aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv (në qoftë se është me kamatë) dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet.

Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga

- të drejta të arkëtueshme tregtare
- aktive financiare te tjera dhe,
- mjete monetare dhe të ngjashme.

Çregjistrimi

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Shoqëria mund të bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Dhënia e informacioneve shpjeguese të mëtejshme lidhur me zhvlerësimin e aktiveve financiare jepet gjithashtu në shënimet e mëposhtme:

- dhënia e informacioneve shpjeguese për supozime të rëndësishme
- te arkëtueshme

SNRF 9 zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura në SNK 39 me një model të humbjes së pritshme të kredisë. Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, humbjet nga kreditë njihen më herët se në SNK 39. Për aktivet në kuadër të modelit të SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi zakonisht pritet të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme. Shoqëria ka

analizuar portofolin e saj dhe vlerëson që rreziku i kreditit për aktivet financiare nuk është rritur që nga njohja fillestare, dhe si rrjedhim duhet të masë provizionin për humbjen e atij instrumenti financiar në një shumë të barabartë me humbjen e pritshme të kredisë për 12-muaj. Shoqëria vlerëson aktivet financiare mbi baza individuale dhe kolektive.

d. Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj

Mjete monetare dhe ekuivalentë të saj përfshin para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para dhe depozita afatshkurtra në bankë me maturitet deri ne 3 muaj.

e. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me çmimin e transaksionit dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.
Një llogari e arkëtueshme përfaqëson të drejtën e Shoqërisë për një shumë që është e pakushtëzuar d.m.th.. kërkohet vetëm kalimi i kohës para pagesës së shumës. Për të arkëtueshme tregtare dhe aktivet e kontratave me klientët, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e HPK. Prandaj, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njeh një zhvlerësim bazuar në HPK-në për të gjithë jetëgjatësinë e të arkëtueshme në çdo datë raportimi. Shoqëria përdor matricën e zhvlerësimit për të llogaritur humbjet e pritshme te kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të drejta te tjera. Shoqëria ka krijuar një matricë zhvlerësimi që bazohet në përvojën e saj historike të humbjes së kredisë. Analiza e zhvlerësimit kryhet në çdo datë raportimi duke përdorur një matricë zhvlerësimi për të matur humbjen e pritshme te kredisë. Normat e zhvlerësimit bazohen në ditët e kaluara për grupimet e segmenteve të ndryshme të klientëve me modelet e humbjeve të ngjashme. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datat e raportimit është vlera kontabël e secilës klasë të aktiveve financiare të prezantuar ne shënimet përkatëse.

f. Aktive nga kontratat

Të drejtat e arkëtueshme janë të drejta në këmbim të mallrave të shitura apo shërbimeve të dorëzuar/pranuara të cilat janë transferuar tek klientët. Nëse Shoqëria ka bërë transferimin e mallrave, shërbime apo materialeve të nevojshme për realizimin e shërbimeve, më parë se shuma të jetë e detyrueshme për t'u faturuar apo paguar, atëherë njihen aktive nga kontratat me klientët për konsideratën e fituar që është e kushtëzuar.
Nëse ndonjëra nga palët në kontratë ka përfunduar pjesën e vetë, njësia ekonomike duhet të paraqesë kontratën në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv kontrate ose detyrim kontrate, në varësi të marrëdhënies mes performancës së njësisë ekonomike dhe pagesës së klientit.
Nëse një njësi ekonomike vepron duke transferuar mallrat apo shërbimet tek një klient para se klienti të paguajë shumën korresponduese ose para se shuma të jetë e detyrueshme për t'u paguar, njësia ekonomike duhet të paraqesë kontratën si një aktiv kontrate, duke përjashtuar çdo shumë të paraqitur si llogari të arkëtueshme. Një aktiv kontrate është një e drejtë e njësisë ekonomike për shumën korresponduese në këmbim të mallrave apo shërbimeve që njësia ekonomike ka transferuar tek një klient. Një njësi ekonomike duhet të vlerësojë një aktiv kontrate për zhvlerësim në përputhje me SNRF Shoqëria transferon mallrat në rrethanat e përshkruara me lart, ndaj njeh aktive nga kontratat në pasqyrat e saj financiare.

l. Detyrimet Financiare

Njohja fillestare dhe matja

Detyrimet financiare klasifikohen, në njohjen fillestare, me vlerën e drejtë dhe, në rastin e huave dhe të pagueshmeve, neto nga kostot e transaksionit të drejtpërdrejtë, që i atribuohen.
Detyrimet financiare të Shoqërisë përfshijnë huate bankare, detyrimet tregtare dhe detyrime të tjera financiare te cilat janë te gjitha klasifikuar si të mbajtura me kosto të amortizuar.

Matja e mëvonshme

Matja e detyrimeve financiare varet nga klasifikimi i tyre, siç përshkruhet më poshtë:

- detyrimet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes;
- me kosto të amortizuar.

Shoqëria nuk mban asnjë detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Kredi me interes dhe huamarrje

Pas njohjes fillestare, kredi me interes huamarrjet maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI"). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur detyrimet çregjistrohen, si dhe përmes procesit të amortizimit të NEI. Kostoja e amortizuar llogaritet

duke marrë parasysh çdo zbritje ose premium, tarifat ose kostot që janë pjesë përbërëse e NEI-së. Amortizimi i NEI është përfshirë si shpenzim financiare në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Çregjistrimi
Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale paguhen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jo monetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

g. Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera
Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me çmimin e transaksionit dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

h. Detyrime nga kontratat
Detyrimet nga kontratat me klientët janë detyrime për të transferuar mallra apo shërbime tek klientët për të cilat Shoqëria ka marrë një parapagim. Një detyrim kontrate është një detyrim i njësisë ekonomike për të transferuar mallra apo shërbime tek një klient për të cilin njësia ekonomike ka marrë shumën korresponduese (ose ka të drejtë për një shumë korresponduese) nga klienti.

i. Provizionet
Provizioni njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur ne përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

Provizionet rishikohen ne çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përftime ekonomike do te kërkohet për të shlyer detyrimin, provizioni anulohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

j. Përfitimet e punonjësve
Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm
Shoqëria, gjatë aktivitetit te saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot qe ndodhin për këto plane i takojnë Shoqërisë dhe ngarkohen ne fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar
Shoqëria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

k. Inventarët

Njohja dhe matja
Inventarët e shoqërisë përbehen lende te para, materiale ndihmese, prodhim ne proces, produkt i gatshëm dhe mallra, duke plotësuar kriteret e mëposhtme si aktive:
a) të mbajtura për shitje në rrjedhën normale të biznesit.
b) në procesin e prodhimit për këto shitje; ose
c) në formën e materialeve apo furnizimeve që do konsumohen gjatë procesit të prodhimit.

Kosto e inventarëve përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e transformimit dhe kosto të tjera të ndodhura për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i shitjes i vlerësuar me çmuarje në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifat doganore dhe sigurimit gjate transportit, si dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës. Kur inventarët shiten, vlera kontabël e tyre njihet si shpenzim në periudhën në të cilën njihen të ardhurat përkatëse.

Zhvlerësimi i inventarëve
Shuma e çdo zhvlerësimi të inventarëve deri në vlerën neto të realizueshme dhe të gjitha humbjet e inventarëve do të njihen si shpenzim në periudhën kur ndodh zhvlerësimi ose humbja. Shuma e ndonjë rimarrje të zhvlerësimit të inventarëve, që vjen nga rritja e vlerës neto të realizueshme, do të njihet si një zbritje e shumës së inventarëve të njohur si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rimarrja. Shoqëria ka llogaritur zhvlerësim te inventarit për disa artikuj, me qarkullim te ngadalshëm, por vlera e tij është e pa rëndësishme.

l. Aktive afatgjata materiale
Njohja dhe matja

Aktivet afat-gjata materiale ppërbehen nga toka dhe ndërtesa, linja teknologjike e prodhimit të ferrokromit si dhe makineri e pajisje në funksion të prodhimit, tregtimit dhe për qëllime administrative. Këto aktive paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen me blerjen e aktivit si dhe çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit (kur njësia është në këto kushte).
Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme. Ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

Kostot e mëpasshme
Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi
Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metodën zbritese te amortizimit, mbi jeten e vleresuar te aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes, per te gjitha klasat e aktiveve afatgjata materiale. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi. Aktivet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Me poshtë janë normat e amortizimit te aplikuara nga Shoqëria për periudhën qe mbyllet me 31 Dhjetor 2020 dhe 2019:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e Amortizimit
Instalime, impiante	Mbi vlerën e mbetur	20%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mjete transporti	Mbi vlerën e mbetur	20%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën e mbetur	20%
Pajisje Informatike	Mbi vlerën e mbetur	25%
Ndërtesa	Mbi vlerën e mbetur	5%
Programe informatike	Mbi vlerën e mbetur	25%
Toka		0%

m. Zhvlerësim i aktiveve jo financiare
Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç aktiveve tatimore të shtyra, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së

drejtë minus koston e shitjes. Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontohen flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimin para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen ne pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim te aktiveve jo financiare.

n. Kapitali

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga vlerat e kontribuara nga ortakët e shoqërisë. Kapitali mbahet në LEKË dhe njihet me kosto historike.

o. Të ardhurat nga kontratat me klientët

Bazuar dhe në SNRF 15, Shoqëria njeh të ardhurat nga kontratat me klientët duke përdorur një model me pesë hapa për kontabilizimin e të ardhurave, si vijon:
- identifikimi i kontratës me një klient;
- identifikimi i detyrimeve të performancës në kontratë;
- përcaktimi i çmimit të transaksionit;
- shpërndarja e çmimit të transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë, dhe
- njohja e të ardhurave kur njësia ekonomike përmbush një detyrim të performancës;

Shoqëria operon në fushën e importit dhe tregetimit të energjise elektrike, te eksportit te ferrokromit, te sherbimeve, e të tjera, per te cilat disponon kontrata, ne te cilat percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve. Kur njeh te ardhurat Shoqeria, vlereson individualisht plotesimin e pese kushteve si me lart cituar, si ne rastin e shitjes se mallrave ashtu edhe ne ofrimin e sherbimeve.
Indentifikimi i kontrates, përcaktimi i detyrimeve referuar saj, percaktimi i kohës së transferimit të kontrollit, në një moment ose përgjatë një kohëzgjatje te caktuar, kërkon gjykim. Të ardhurat nga kontratat me klientët per shitjen e mallrave njihen kur jane plotesuar kushtet si me lart dhe kontrolli i mallrave i transferohet klientit në një shumë e cila pasqyron shumën që Shoqëria pret në këmbim të transferimit të këtyre mallrave, bazuar në faturën tregtare e cila shoqëron mallrat objekt shitje, duke filluar nga koha e dorezimit/marrjes ne dorezim te mallrave nga palet. Në një kontratë për shitje mallrash (energji, ferrokrom) nuk ka premtime të tjera që janë detyrime të vecanta të performancës për t'u ndarë, të cilave iu duhet alokuar një pjesë e cmimit. Të ardhurat njihen në një moment të kohës. Afati normal i kredisë që aplikohet është 30 në 180 ditë pas dorëzimit/faturimit, afat i cili përgjithësisht zbatohet nga klientet (shenimi nr.17).
